

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6459
E martë, 9 nëntor 2021
çmimi 0.40 €

Reagim i KMDLNJ-së
**Dhomat e Specializuara
vazhdojnë t'i shkelin të
drejtat e njeriut!** FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KA VAZHDUAR EDHE TË HËNËN NË HAGË PROCESI GJYQËSOR NDAJ
DY UDHËHEQËSVE TË OVLUÇK-SË FAQE 4-5

GUCATI DHE HARADINAJ THONË SE JANË TRAJTUAR ME PËRBUZJE NGA GJYKATA SPECIALE



Udhëheqësit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së kanë kundërshtuar akuzat e Dhomave të Specializuara të Hagës ndaj tyre. Në seancën e së hënës para trupit gjykues Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj kanë thënë se procesi ndaj tyre është i padrejtë dhe se prokuroria nuk ka prova për aktakuzën. Sipas tyre, Gjykata Speciale është mbështetur nga Serbia. Mbrojtja e Gucatit dhe Haradinajt ka lënë të hapur mundësinë për të ftuar dëshmitarë që tregojnë pafajësinë e klientëve të tyre

AKTUALE



**POLONIA RRRIT SIGURINË
NË KUFIT ME BJELLORUSINË** F. 2

**PUNONJËSIT E ARSIMIT DHE TË
SHËNDËTËSISË PARALAJMËROJNË
GREVË** F. 6

**TETË RASTE TË REJA ME COVID
NË KOSOVË** F. 6

EKONOMI



**KURTI VIZITOI NDËRMARRJEN
VENDORE QË BËN PËRPUNIMIN
E FRUTAVE TË MALIT** F. 8

**ATK-ja PËR DHJETË MUAJ
REALIZOI MBI 500 MILIONË
EURO TË HYRA** F. 8

SPORT



**'DARDANËT' FILLOJNË
GRUMBULLIMIN, KONFIRMOHEN
TRI MUNGESA** F.10

FILLON FUSHATA PËR BALOTAZHIN

FAQE 7



HARADINAJ: KOSOVA PO HYN NË KRIZË TË THELLË SOCIALE

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepgjisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Polonia shton sigurinë në kufi me Bjellorusinë

VARSHAVË, 8 NËNTOR - Polonia ka njoftuar se ka shtuar masat e sigurisë në kufirin e saj lindor me Bjellorusinë pasi disa video të publikuara në rrjetet sociale tregonin qindra migrantë që po shkonin në drejtim të kufirit. Në njërin nga videot migrantët mbanin çanta në shpinë dhe ishin të veshur me rroba të dimrit. Ata po ecnin në një anë të një autostrade me një pankartë të shkruar në gjuhën bjelloruse.

Një video tjetër video shfaqte një grup të madh burrash dhe grash të shoqëruar nga persona të armatosur me uniformë ushtarake.

Ministria e Mbrojtjes e Polonisë

shpërndau një video që tregonte një grup migrantësh pranë pikës kufitare Bruzhi-Kuznica. "Bjellorusia dëshiron të shkaktojë një incident të madh, mundësisht me të shtëna dhe viktima", ka thënë zëvendësministri i Jashtëm polak, Piotr Wawrzyk, për radion publike polake.

Në muajt e fundit mijëra migrantë nga Lindja e Mesme, Azia Jugore dhe Afrika janë përpjekur që nga Bjellorusia të hyjnë ilegalisht në Poloni, Letoni dhe Lituani.

Bashkimi Evropian ka akuzuar diktatorin bjellorus Alyksandr Lukashenka, se po krijon krizë me migrantë për t'iu hakmarrë



Brukselit për shkak të sanksioneve të vendosura pasi autoritetet bjelloruse goditën opozitën, shoqërinë civile dhe mediat e pavarura pas zgjedhjeve të kundërshtuara

presidenciale të vitit të kaluar. Lukashenka thotë se i ka fituar zgjedhjet, mirëpo opozita dhe vendet perëndimore nuk e njohin rezultatin dhe thonë se ka pasur manipulime masive.

Ministri polak i Mbrojtjes, Mariusz Blaszczak, më 8 nëntor tha se më shumë se 12 000 ushtarë janë vendosur në kufi. Ai tha se autoritetet janë "të përgatitura për ta mbrojtur kufirin polak". "Mbrojtja e kufirit është prioriteti ynë", ka shkruar ai në rrjetin social "Twitter".

Polonia ka vendosur një gjendje të jashtëzakonshme në kufi. Ky vend anëtar i Bashkimit Evropian gjithashtu ka vendosur rrethoja me tela për ta frenuar fluksin e migrantëve që kalojnë nga Bjellorusia. Ligjvënësit polakë kanë miratuar, gjithashtu, ndërtimin e një muri prej 407 milionë dollarësh në kufirin e lindor.

Policia maqedonase zbulon dhjetëra migrantë të paligjshëm

SHKUP, 8 NËNTOR - Policia e Maqedonisë së Veriut ka zbuluar dhjetëra migrantë në një kamion pranë kufirit grek.

Policia ka njoftuar se derisa po ndiqte një kamion pranë qytetit Star Dojran, 160 kilometra në jug të kryeqytetit, Shkupit, shoferi i kamionit dhe një pasagjer u hodhën papritur nga mjeti në lëvizje dhe kamioni goditi makinën e policisë.

Nuk u raportua për të lënduar nga radhët e policisë.

Gjatë kontrollit, policia gjeti 42 migrantë. Njëri ishte nga



Bangladeshi, pjesa tjetër nga Siria.

Në gjashtë muajt e fundit ky ishte grupi i parë i madh i migrantëve

të paligjshëm që janë zbuluar nga ana e autoriteteve maqedonase. Grupi u zhvendos në një strehimore emigrantësh në Gjevgjeli në kufirin me Greqinë.

Policia beson se ata kishin arritur përmes Greqisë dhe tha se do t'i dëbojë përsëri atje. Maqedonia e Veriut është një rrugë transiti për migrantët që përpiqen të kalojnë nga Greqia në vendet më të pasura në Evropën Perëndimore dhe Veriore.

Kontrabanda e njerëzve ka mbetur aktive në rajon

pavarësisht prej mbylljes së kufijve dhe kufizimeve të lëvizjes gjatë pandemisë Covid-19, megjithëse numrat kanë rënë.

Një valë refugjatësh ndezi tensione gjatë krizës evropiane të migracionit më 2015 dhe 2016 dhe nxiti veprime të ashpra nga Shkupi për të parandaluar migrantët që ta përdorin Maqedoninë e Veriut si rrugë transiti.

Kundërmasat e Shkupit të ndërmarra gjashtë vjet më parë përfshinin ngritjen e një gardhi në kufirin me Greqinë.

Kuvajti planifikon amnistimin e disidentëve politikë



KUWAIT CITY, 8 NËNTOR - Qeveria e Kuvajtit ka miratuar projektdekrete për t'i amnistuar disidentët politikë. Ligjvënësit e opozitës e kishin vënë si kusht amnistinë për t'i dhënë fund bllokimit disa muajsh të punës së legjislativit. Kabineti miratoi projektdekrete e nevojshme për t'ia dorëzuar Emirit", ka njoftuar qeveria në njoftimin për media.

Emiri i Kuvajtit, Sheikh Nawaf al-Ahmad al-Sabah, urdhëroi

kryetarin e parlamentit, kryeministrin dhe kreun e Këshillit Suprem Gjyqësor të bëjnë rekomandimet për kushtet e amnistisë para se ajo të shndërrohet në dekret.

Një javë më parë këto institucione kishin paraqitur një "raport paraprak" që përcaktonte kushtet e amnistisë së planifikuar.

Zyra e Emirit, përmes një deklaratë, tha se amnistia do t'i përfshinte

"disa kuvajtianë të dënur në rastet e kaluara", megjithëse nuk dha hollësi.

Disidentët në mërgim përfshijnë ish-ligjvënës që morën pjesë në një sulm në parlament në vitin 2011 mbi korrupsionin dhe keqmenaxhimin e supozuar të qeverisë. Dekreti mund të amnistojë edhe disa kuvajtianë që u burgosën pasi kritikuan hapur Emirin.

Wang Yaping bëhet gruaja e parë kineze që ecën në hapësirë

PEKIN, 8 NËNTOR - Astronautja Wang Yaping u bë gruaja e parë kineze që eci në hapësirë pasi ajo është pjesë e një ekipi që po punon për ndërtimin e stacionit hapësinor Tiangong.

Autoritetet kineze, më 8 nëntor, thanë se 41-vjeçarja Wang dhe kolegu i saj Zhai Zhigang, 55 vjeç, dolën nga moduli për të instaluar një

pajisje në pjesën e jashtme të stacionit hapësinor.

Pas uljes së një sonde në Mars dhe dërgimin e sondave të tjera në Hënë, projekti Tiangong është pjesë e përpjekjes së Kinës për t'u bërë një fuqi hapësinore. "Është shënuar aktiviteti i parë jashtë anijeve hapësinore të ekuipazhit Shenzhou-13

dhe është gjithashtu i pari në historinë hapësinore të Kinës që përfshin pjesëmarrjen e një gruaje", ka njoftuar Agjencia Hapësinore Kineze në një deklaratë. "I gjithë procesi ishte i suksesshëm", ka njoftuar kjo agjenci. Stacioni Tiangong pritet të operojë në hapësirë për të paktën 10 vjet.



Fillon fushata për balotazhin

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Të hënën ka filluar zyrtarisht fushata zgjedhore për balotazhin.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se fushata për zgjedhjet lokale, për raundin e dytë, do të zgjasë pesë ditë.


Partitë politike thuajse për asnjë ditë nuk i kanë ndaluar aktivitetet e fushatës edhe pas përfundimit të raundit të parë dhe përcaktimit të afatit nga KQZ-ja.

Në disa komuna partitë politike tashmë veçse i kanë zyrtarizuar edhe marrëveshjet për ta mbështetur njëra-tjetrën.

Raundi i dytë i zgjedhjeve do të mbahet në 21 komuna ku asnjëri prej kandidatëve për kryetarë të komunave nuk arriti të marrë 50+1 për qind të votave.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, përmes një videoadresimi në llogarinë e vet në "Facebook", u ka kërkuar qytetarëve mbështetje për tetë kandidatët e PDK-së për kryetarë komunash të cilët do të garojnë në balotazh më 14 nëntor. "Fitorja e radhës na pret më 14 nëntor, sepse kandidatët më të mirë në Prizren, Vushtrri, Klinë e Malishevë, ashtu si në Drenas, Kaçanik, Dragash e Shtime, janë në numrin 177. Mbështetja e tyre të dielën është lajmi më i mirë për qytetarët e këtyre komunave për katër vjetët e ardhshëm", ka shkruar Krasniqi.

Ai i ka falënderuar qytetarët për besimin që i dhanë PDK-së dhe kandidatëve të saj për kryetarë komunash dhe për asambletë komunale më 17 tetor. "Fituam më së shumti komuna e asamblistë në raundin e parë dhe tani një tjetër fitore na pret në



raundin e dytë. Në tetë komunat ku ne garojmë në balotazh, kandidatët tanë përfaqësojnë vlerat më të mira dhe kanë programet më të duhura", ka thënë ai. Krasniqi shprehet se në Prizren, Vushtrri, Klinë dhe Malishevë duhet të rikthehet modeli qeverisës zhvillimor e transformues i PDK-së, ashtu siç është e nevojshme dhe tejet e rëndësishme që të vazhdohen qeverisjet shembullore në Drenas, Kaçanik, Shtime dhe Dragash. "Më 14 nëntor na duhet mbështetja juaj, e tillë si në raundin e parë, kur tejkaluat barrierat partiake dhe votuat PDK-në, për ta fituar qeverisjen e mirë që meritoni, me kryetarë që

punojnë pa dallime dhe ndershmerisht. Prandaj, le të bëhemi bashkë për fitoren e radhës, në numrin 177, për të qeverisur në katër vjetët e ardhshëm, bashkë për Kosovën", ka deklaruar Krasniqi.

Ndërkaq kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka postuar në llogarinë e vet në "Facebook" një video në mbështetje të Arben Vitisë për Prishtinën. Kurti ka ftuar edhe Glauk Konjufcën, Hekuran Muratin, Artane Rizvanolli, Hajrulla Çekun, Rozeta Hajdarin, Donika Gërvallën e të tjerët, që t'i tregojnë me video arsyet dhe planet e tyre për ta mbështetur Vitinë për qeverisjen në Prishtinë. "Unë i kam 144 arsye për të votuar për Benin, por sot do ta ndaj vetëm një me ju: Beni do ta ketë mbështetjen time të plotë për planet e tij konkrete dhe të zbatueshme me të cilat do të zhvillohet Prishtina. I ftoj edhe kolegët e mi Glauk Konjufca, Hekuran Murati, Artane Rizvanolli, Hajrulla Çeku, Rozeta Hajdari, Donika Gërvalla e të tjerët t'i tregojnë me video arsyet dhe

planet e tyre për ta mbështetur Benin në transformimin e Prishtinës. Të dielën, më 14 nëntor, mos harro. Dil e voto!", ka shkruar Kurti.

Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Prishtinës, Përparim Rama, ka shpallur të hënën projektin për lagjen "Dardania". Ai ka thënë se në këtë lagje do të mundësojnë nënkalimin për vetura dhe do të krijojnë parkun urban. "E gjithë sipërfaqja përmby nënkalimin për vetura do të transformohet në park urban, me mundësi të lëvizjes vetëm për këmbësorë, për persona me aftësi të kufizuara, për biçikleta dhe trotinet, me çka do të lehtësohet dhe shkurtohet qasja e banorëve të 'Kalabrisë' me 'Dardaninë' dhe qendrën", ka thënë Rama.

Nënkryetari i AAK-së u ka bërë thirrje qytetarëve të Gjakovës që më 14 nëntor ta votojnë Ardian Gjinin. "Për të gjithë ata që në formë të ndryshme vijjnë në Gjakovë vetëm për fushatë zgjedhore, duhet t'ua vulosim humbjen më 14 nëntor sepse ata janë përçarësit e ne jemi bashkimi.

Ata janë fjalët bosh, ne jemi puna e vërtetë, dhe kësaj herë njëherë e përgjithmonë duhet të vendosim për të mirën e përbashkët për Ardian Gjinin kryetar i Gjakovës", ka deklaruar Lekaj.

Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Lidhja Demokratike e Kosovës ka dalë partia e parë për nga numri i votave për kuvende komunale. Kjo parti ka marrë 170 134 vota për kuvendet komunale. Pas saj renditet Lëvizja Vetëvendosje me 168 084 vota, Partia Demokratike e Kosovës me 161 645 vota dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka marrë 9 863 vota.

Sipas këtyre rezultateve, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë më së shumti këshilltarë komunalë, nga 206 secila në tërë vendin.

LV-ja ka siguruar 193 ulëse në kuvendet komunale, AAK-ja do të ketë 120 asamblistë, Nisma në të gjithë vendin ka fituar 21 ulëse, kurse Aleanca Kosova e Re do të ketë vetëm 8 asamblistë.

Lista Serbe në komunat ku ka garuar do të ketë 147 këshilltarë komunalë.

Vendimi i PZAP-it: Do të rinumërohen të gjitha votat për asamblistë në Podujevë

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka marrë vendim për rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për Kuvend Komunal në Podujevë. Këtë vendim PZAP-i e ka marrë pas ankesës së bërë nga kandidati për asamble në këtë komunë nga radhët e LV-së, Xhevdet Maloku dhe 119 kandidatët të tjerë nga të gjitha partitë politike.

Dorëzohet kallëzim penal kundër Liburn Aliut

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Ndërmarrja Publike Banesore (NPB) në Prishtinë ka njoftuar se ka dorëzuar kallëzim penal ndaj ministrit të Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu. Në njoftimin e kësaj ndërmarrjeje thuhet se Aliu i ka shkaktuar dëm të madh NPB Sh.a. Kallëzimi penal ndaj ministrit të MAPHI-së është bërë për shkak të "Keqpërdorimit apo autoritetit zyrtar".

Ndërmarrja Publike Banesore sot ka dorëzuar pranë Prokurorisë Speciale kallëzim penal kundrejt Liburn Aliut, ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. NPB qëndron e bindur që z. Aliu përmes veprimeve të tij ka tejkaluar përtej çdo dyshimi kompetencat e tij dhe kësajsoj tashmë u ka shkaktuar dëm jashtëzakonisht të madh interesave ekonomike dhe pronësore të NPB-së. Në këtë

kallëzim penal prej dhjetë faqesh e dhjetëra faqesh prova, NPB ka argumentuar se si, ku dhe si është shkelur legjislacioni në fuqi nga z. Aliu asisoj që i njëjti ka konsumuar veprën penale 'Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar' të paraparë me nenin 414 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. NPB qëndron e vendosur të krijojë kapacitetet e saj financiare dhe njerëzore ashtu që në të ardhmen e afërt të jetë një faktor i



rëndësishëm i ndërtimit në qytet me qëllimin e vetëm që të ofrojë banim të përbalueshëm për shumë

familje që sot qëndrojnë të përjashtuara nga ofertat e tregut të patundshmëri", ka njoftuar NPB-ja.



KA VAZHDIJEDHE TË HËNËN NË HAGË PROCESI GJYQËSOR NDAJ DY UDHËHEQËSVE TË OVLUÇK-SË

Gucati dhe Haradinaj thonë se janë trajtuar me përbuzje nga Gjykata Speciale

Udhëheqësit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së kanë kundërshtuar akuzat e Dhomave të Specializuara të Hagës ndaj tyre. Në seancën e së hënës para trupit gjykues Hysni Guçati dhe Nasim Haradinaj kanë thënë se procesi ndaj tyre është i padrejtë dhe se prokuroria nuk ka prova për aktakuzën. Sipas tyre, Gjykata Speciale është mbështetur nga Serbia. Mbrojtja e Guçatit dhe Haradinajt ka lënë të hapur mundësinë për të ftuar dëshmitarë që tregojnë pafajësinë e klientëve të tyre

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kryetari dhe nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së janë deklaruar të hënën për procesin ndaj tyre në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Hysni Guçati dhe Nasim Haradinaj para trupit gjykues kanë kritikuar këtë gjykatë, duke thënë se Specialja është mbështetur në dokumente të ofruara nga Qeveria e Serbisë dhe procesin ndaj tyre e kanë vlerësuar të padrejtë.

Guçati dhe Haradinaj kanë theksuar se Gjykata Speciale nuk ka asnjë argument kundër tyre. I pari që iu ka drejtuar gjykatës ka qenë kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Guçati. Fillimisht ai ka treguar historinë e fshatit të tij të lindjes, Morinë e Skenderajt, duke thënë se ky vend gjatë

luftës së fundit ka humbur më së shumti njerëz për kokë banori. Ai ka deklaruar se gjatë viteve 1998-1999 së bashku me babanë i është bashkuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për t'i mbrojtur të drejtat elementare të njeriut, siç janë liria dhe e drejta për një jetë të lirë në vatrën tona. "Në luftimet e qershorit të vitit 1999 unë jam plagosur nga forcat serbe dhe si pasojë e asaj ec si gjithë njerëzit e tjerë. Ne si popull më i vjetër në Ballkan nuk e kemi pushtuar Serbinë, por vendi ynë ka qenë i pushtuar nga Serbia. Këtu jemi duke qëndruar padrejtësisht më shumë se një vjet. Ne nuk kemi bërë asnjë mëkat", ka deklaruar Guçati.

Ai ka përmendur masakrat që forcat serbe kanë kryer gjatë luftës në Kosovë. "Kemi shfrytëzuar të drejtën tonë të

fjalës së lirë, të mendimit e të shprehjes së lirë. Të drejtën e fituar me sakrificë njerëzore e jonjerëzore. Vetëm gjatë marsit, prillit, majit e qershorit të vitit 1999 në popullin tonë janë kryer mbi 450 masakra e krime të gjenocidit serb. Pa i përmendur ato të viteve '90. Gjatë luftës së fundit në Kosovë janë vrarë mbi 1 400 fëmijë e dhunuar mbi 20 mijë gra. Janë vrarë mijëra pleq, të mbetur e të palëvizshëm, që nuk kanë mundur të largohen nga shtëpitë. As sot e kësaj dite nuk dimë asgjë për fatin e mbi 1 600 njerëzve të zhdukur. Pa folur këtu për shkatërrimet e shkaktuara nga makineria serbe", është shprehur ai, duke shtuar se është e drejtë e tij t'i mbrojë vlerat kombëtare. "Është e drejtë legjitime e imja t'i mbrojt të drejtat dhe vlerat e UÇK-së dhe të republikës së shtetit

tim të Kosovës. Jam i obliguar t'i mbrojt të drejtat e liritë e popullit për jetë më të mirë e më të begatë, si gjithë popujt e kontinentit tonë", ka thënë Guçati.

Kurse nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, ka deklaruar se Zyra e Prokurorisë së Specializuar është e përkrahur nga Qeveria e Serbisë. Ai ka thënë se prokuroria është duke e trajtuar atë me përbuzje. "Kjo prokurori po e dëshmon atë që e kam thënë unë me OVL-në. Kushdo që ka kryer krim, nuk meriton aspak dhe duhet të përballet me drejtësinë. Prokurori Jack Smith qëndroi para jush dhe tha 'kjo s'ka të bëjë me UÇK-në'. Kjo është gënjeshtër. Është pikërisht e kundërta. Kjo prokurori po e falënderon Qeverinë e Serbisë për mbështetjen e dhënë", ka deklaruar Haradinaj.

Ai ka thënë se prokuroria nuk e ka asnjë provë ndaj tij. "Prokuroria nuk e meriton që unë të jem këtu, që t'ju bëj dekorin. Vendosa të vij këtu të them të vërtetën. Veprimet e kësaj prokurorie dëshmojnë se jam këtu prej 14 muajsh, kur asnjë provë nuk mund t'i

mbështesë akuzat qesharake", ka deklaruar ai.

Haradinaj i ka bërë thirrje trupit gjykues që ta përfundojnë këtë çështje. "Të nderuar anëtarë të panelit, gjykatës dhe ju përfaqësues të shtetit tim që jeni sot aty dhe më dëgjoni, këto komente të shkurtra i bëj si qytetar krenar i Republikës së Kosovës, që i është nënshtruar një procesi nga Prokuroria që mund të cilësohet vetëm si e padrejtë dhe selektiv. Tani ju bëj thirrje, të nderuar gjyqtarë, të një institucioni kombëtar të vendit tim të lindjes, ta përfundoni këtë çështje", ka thënë Haradinaj.

Para se Zyra e Prokurorit të Specializuar ta mbyllë zyrtarisht çështjen, avokatët e Guçatit dhe Haradinajt kanë lënë të hapur mundësinë për të sjellë dëshmitarë.

Jonathan Elystan Rees, avokat i Hysni Guçatit, ka thënë se kanë disa dëshmitarë. "Provat e ZPS-së ose çështja e ZPS-së, përpara mbylljes, duhet të përfshijë jo vetëm mundësinë për pyetje të plotë të këtyre tre dëshmitarëve të mbrojtjes, por ZPS-ja duhet të thërrasë, qoftë edhe për të paraqitur si dëshmitar të çështjes së tyre një person që është i aftë

Reagim i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNJ)

Dhomat e Specializuara vazhdojnë t'i shkelin të drejtat e njeriut!

Më 5 nëntor 2020 Dhomat e Specializuara arrestuan Hashim Thaçin, ish-president i Kosovës, Jakup Krasniqin, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe u.d. i presidentit të Kosovës, Kadri Veselin, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i PDK-së si dhe Rexhep Selimin, ish-kryetar i grupit parlamentar i LV-së. Që të gjithë ishin themelues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më herët ishte arrestuar Salih Mustafa-Cali, ish-udhëheqës i BIA-së gjatë luftës, kurse më vonë u arrestuan Hysni Gucati, kryetar i OVL-së së UÇK-së dhe Nasim Haradinaj, zëvendëskryetar i OVL-së së UÇK-së. I fundit që u arrestua ishte Pjetër Shala, ish-ushtar i UÇK-së. Kundër Salih Mustafës-“Calit”, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt në afat të arsyeshëm kishin përfunduar hetimet dhe procesi gjyqësor është duke u zhvilluar sipas dinamikës së paraparë. Ndaj tyre kemi të bëjmë me shkelje flagrante të përdorimit të gjuhës zyrtare në Kosovë e që është edhe gjuha amtare e të akuzuarve - gjuha shqipe për faktin se edhe konfirmimi i aktakuzës ishte përkthyer vetëm pjesërisht në gjuhën shqipe që e vështirëson përgatitjen e mbrojtjes. Ndaj tyre kishin shkelje të drejtave të njeriut edhe gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore si dhe mospajjsja me kohë me viza afatgjata e një rast një familjari i ishte refuzuar viza hyrëse duke e bërë të pamundur vizitën familjare. KMDLNJ nuk e komenton fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarve për faktin se kjo vërtetohet apo mohohet me një vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente. KMDLNJ përcjellë me shumë kujdes respektimin apo shkeljen e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria, tash të paraburgosur në Njësinë e Paraburgimit të Gjykatës Speciale në Hagë, si *conditio sine qua non* - kusht i domosdoshëm për një proces gjyqësor të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht e që në rastin konkret lë shumë për të dëshiruar, që nga çasti i arrestimit e deri më tani! Shkelja e parë, ende pa filluar mirë

procesi ishte bërë kur para një arrestimi të ngutshëm ishin bërë publik vetëm emrat e të arrestuarve me një arsytim se ndonëse ishte e kundërligjshme, ishin të detyruar ta bëjnë publik këtë listë të ngushtë sepse të arrestuari paskan bërë përpjekje të vazhdueshme për pengimin e punës së Gjykatës Speciale dhe paskan bërë, gjithashtu përpjekje për zhbërjen e saj. Ky ishte rasti i parë që ishte vepruar në këtë mënyrë e që më parë nuk e kishte bërë asnjë Gjykatë Ndërkombëtare për Krime Luftë e që ishte paragjykim i orkestruar me qëllim të prezumimit të pafajësisë. Bastisjet dhe sjellja gjatë bastisjeve ishte në kundërshtim me të drejtat e njeriut sidomos në rastin e Jakup Krasniqit dhe veteranëve të OVL-së së UÇK-së. Versioni i shkurtër i konfirmimit të aktakuzës ishte dorëzuar kryesisht në gjuhën angleze që është gjuhë e punës së GJS-së por jo edhe gjuhë zyrtare në Kosovë.

Neglizhenca për përkthim të tërësishëm të materialeve e vë në pozitë të pabarabartë të akuzuarin duke ia dobësuar cilësinë e mbrojtjes. Deri më tani, përveç premtimeve se po punohet në përkthim të materialeve, nuk ka asnjë përpunim që siguron se kjo do të përmbushet ashtu si e parasheh Ligji për Përdorim të Gjuhëve Zyrtare në Kosovë.

Në një rast nga seancat e para dëgjimore, Zyra e Prokurorit të Specializuar vëri nën presion të akuzuarit dhe mbrojtësit duke deklaruar se gjykimi duhet të fillojë në shtator të vitit 2021 në ndërkohë që po kjo zyre, në mungesë të provave vazhdimisht kërkon shtyrje të afateve për dorëzimin e dosjeve paraprake të Prokurorisë duke premtuar se këtë do ta bëjë deri më 17 dhjetor 2021 duke e penguar mbrojtjen (për shkak të mungesës së dosjes paraprake), ta përgatisë mbrojtjen efektive. Luajtja me afate e ZPS-së për dorëzimin e dosjes paraprake e ka zgjatur kohën e paraburgimit përtej afateve të arsyeshme. Deklaratat publike të prokurorit të ZPS-së se një apo më shumë i akuzuar mund të dënohen me



burgim të përjetshëm është ndërhyrje dhe presion në punën e GJS-së për faktin se e prezumon pafajësinë. Sipas legjislacionit në fuqi dhe ligjeve më të favorshme për të akuzuarit në kohën kur dyshohen se kanë bërë krime luftë dhe krime kundër njerëzimit, dënimi maksimal që mund të shqiptohet është 20 vjet. Së paku kështu është vepruar në Kosovë e GJS-së që është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, qoftë edhe formalisht. Shkarkimi apo zëvendësimi i një gjykatësi të GJS-së sepse ka lënë mundësinë që masa e paraburgimit mund të zëvendësohet me një masë tjetër në rast se një shtet i tretë jep garanci ka ndikuar që të pamundësohet zbatimi i kësaj mase duke ua vazhduar paraburgimin në Njësinë e Paraburgimit në Hagë. Hezitimi apo mosdashja e gjykatësit të procedurës paraprake, Nikolas Giju të kërkojë nga Policia e Kosovës dhënien e garancive që të sigurojë kapacitete në rast të lirimit të përkohshëm deri sa u urdhërua, pas miratimit të ankimit të palës mbrojtëse, nga Dhoma e Apelit e Gjykatës Speciale gjithashtu shkel të drejtat e garantuara nga Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara, KEDNJ dhe Kushtetutës së Kosovës mbi tejkallimin e një paraburgimi

përtej kohës së arsyeshme e që në rastin konkret e pohoi edhe kryetarja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trandafilove kur deklaroi se: “mbajtja në paraburgim më shumë se një (1) vjet është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Kjo nënkupton qartazi se kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria përmes zgjatjes së paraburgimit përtej afateve të arsyeshme. Gjithashtu, edhe largimi i shefit të Hetuesisë së ZPS-së është një tregues se, për shkak të përgjegjësisë morale eventualisht edhe po ndodhë ky largim. KMDLNJ e konsideron se ndaj të paraburgosurve, shtetas të Kosovës e që janë në Njësinë e Paraburgimit në Hagë ka shkelje flagrante të të drejtave të njeriut, një pjesë e të cilave u listua më lartë. Në këtë kontekst, KMDLNJ konsideron se janë krijuar të gjitha kushtet që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të kërkojnë ta shqyrtojnë mandatin e kësaj Gjykate Speciale e cila ishte themeluar me votën e deputetëve të Kuvendit, jo me qëllim të ndërhyrjes apo pengimit të drejtësisë por me qëllim që të mbrohen të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria të cilat janë të garantuara me aktin më të lartë juridik të Kosovës, Kushtetutës së Kosovës. Kërkesa për rishqyrtim të mandatit të

Gjykatës Speciale nuk mund të merret si kërkesë për zhbërje të kësaj gjykate por angazhim që ndikon në respektimin e të drejtave të njeriut të shtetasve të Kosovës, tash të paraburgosur, ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies që është në pikën më të ulët dhe krijimin e kushteve për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm! Të gjitha këto që po i kërkon KMDLNJ janë të garantuara me të gjitha dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e personave të privuar nga liria, në veçanti!

Deri atëherë, KMDLNJ fton organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ta bëjnë monitorimin efektiv të proceseve gjyqësore para Gjykatës Speciale në Hagë në mënyrë që të ndërpritet me shkeljen evidente të të drejtave të njeriut të personave të paraburgosur. Zgjatja përtej arsyes e masës së paraburgimit përveçse tregon dhe dëshmon joseriozitetin e ZPS-së, i zbeh provat duke i bërë ato të pabesueshme ose më pak të besueshme, dëmton të drejtat e viktimave për të siguruar drejtësi sikur që ua shkel të drejtat e njeriut personave të paraburgosur. Është formuar një qark i mbyllur ku dihet kur ka filluar procesi, por nuk dihet edhe kur do të përfundojë!

të dëshmojë për hetimin që ata kanë kryer lidhur me akuzat për shtyrje për vepër penale”, ka thënë ai.

Edhe Toby Cadman, avokat i Nasim Haradinajt, ka thënë se me mbrojtjen e Gucati dhe kanë një listë të përbashkët të dëshmitarëve. “Synimi ynë në këtë fazë është që edhe z. Haradinaj të thirret për të dhënë dëshmi, por shumë nga kjo varet se çfarë do të ndodhë këtu. Lista aktuale e dëshmitarëve, sipas

vendimit tuaj, do të varet nga rezultati i disa çështjeve, por ne do të bëjmë çmos t'u ndihmojmë sa më shumë të jetë e mundur. Kemi një listë të përbashkët dhe nuk do të përsëritim dëshmitarët, pra ose njëri ose tjetri do të thërrasë dëshmitarin që do të mund t'u shërbejë interesave të të dyve për ta ndihmuar gjykatën në këtë mënyrë. Por, megjithatë, ka disa çështje që duhen zgjidhur, kështu që është e pamundur të

themi më shumë se kaq”, ka thënë Codman.

Në gjykimin ndaj ish-krerëve të OVLUÇK deri tani janë dëgjuar katër dëshmitarë të ZPS-së. Gjykimi ndaj Gucati dhe Haradinajt ka filluar më 7 tetor të këtij viti. Veprat penale që rëndojnë ndaj Gucati dhe Haradinajt, sipas Dhomave të Specializuara, janë se janë kryer në periudhën 7-25 shtator 2020. “Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar

mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet

sociale”, është thënë në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

Që të dy janë arrestuar më 25 shtator në Prishtinë dhe që atëherë gjenden në qendrën e paraburgimit në Hagë. OVLUÇK-ja në shtatorin e kaluar ka pranuar, në mënyrë anonime, dosje që lidhen me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Përmbajtja e këtyre dosjeve nuk është bërë e njohur dhe nuk është konfirmuar nëse ato janë autentike apo jo.

Punëtorët e arsimit dhe të shëndetësisë paralajmërojnë grevë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka paralajmëruar grevë në sektorin e arsimit. Në protestën e organizuar nga Federata e Sindikatave e Mjekëve të Kosovës ai ka deklaruar se nëse deri në janar të vitit të ardhshëm nuk zbatohet Ligji i Pagave do të ketë grevë në sistemin arsimor. “Ne jemi duke u përgatitur për dialog, por nëse dialogu mungon dhe në janar nuk zbatohet Ligji i Pagave, atëherë sistemi arsimor do të jetë i tëri i bllokuar dhe do të kemi greva. Kështu do të kemi humbje orësh në arsim. Një gjë duhet ta dinë të gjithë. Ne nuk jemi fajtorë”, ka deklaruar Jasharaj. Ai ka kërkuar nga qeveria që t’ua plotësojë kërkesat. “Kam ardhur këtu që të sjell

mesazhin e mijërave punëtorëve të arsimit të cilët i bashkëngjiten me shpirt e zemër kësaj proteste dhe kam ardhur t’i them qeverisë që ta dëgjojë këtë masë njerëzish që përfaqësojnë tërë sistemin shëndetësor, të cilët koha i kthej në hero, sepse ata po luftojnë dhe kanë luftuar kundër vdekjes për të shpëtuar jetë. E lus qeverinë që të bashkohet dhe të flasë me ne në mënyrë që ky shesh të mos jetë plot njerëz, në mënyrë që sistemi arsimor mos t’u kthehet grevave”, ka thënë Jasharaj.

Kryetari i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë, Blerim Syla, ka kërkuar nga qeveria që të jetë transparente dhe bashkëpunuese në përpilimin e Ligjit për Pagat në sektorin publik.

Syla ka paralajmëruar bllokimin e institucioneve shëndetësore nëse nuk merret ndonjë iniciativë, duke i dhënë afat edhe një javë



qeverisë. “Kërkesa jonë e vetme është Ligji i Pagave. Andaj ne sot kemi dalë t’i themi ‘Stop’ kësaj jotransparence, që nëse Ligji i Pagave nuk shkon sivjet, kjo protestë do të kthehet në reagime më të ashpra

sindikale”, ka thënë Syla. Atdhe Hykolli, kryetar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), ka thënë se qeveria duhet sa më shpejt t’i thërrasë sindikatat për dialog social. “Unë do të jem çdoherë përballë

kërkesave të sindikatave. Në këtë rast kërkoj nga Qeveria e Kosovës që sa më shpejt t’i thërrasë sindikatat për dialog social. Ftoj qeverinë që t’i çojë përfaqësuesit e vet në Këshillin Ekonomik Social”, ka deklaruar Hykolli.

Tërnavë pret në takim komandantin e KFOR-it, diskutojnë për bashkëpunimin e dyanshëm

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur të hënën në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Ferenc Kajari. Në këtë takim Tërnavë i ka uruar mirëseardhje gjeneralmajorit Kajari, të cilin e ka uruar për detyrën, duke vlerësuar kontributin e forcës shumëkombëshe për sigurimin e një ambienti të qetë e të sigurt në Kosovë, si dhe i ka uruar punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin e tij. Ai më pas e ka njoftuar me punët dhe aktivitetet që zhvillojnë institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim. Myftiu Tërnavë edhe një herë ka shprehur mirënjohjen e tij



për misionin dhe përkushtimin e forcave paqeruajtëse të KFOR-it, duke shprehur kështu vlerësimin dhe respektin e lartë

që kanë qytetarët e Kosovës për ta. Tërnavë ka theksuar se forcat e KFOR-it deri më tash kanë

kontribuar jo vetëm në fushën e sigurisë, por edhe në projekte të ndryshme infrastrukturore, sikurse edhe në fushën e

shëndetësisë në përballje me pandeminë, ku edhe me institucionet e BIK-ut janë zhvilluar shumë projekte të përbashkëta në të mirë të komunitetit.

Nga ana e tij, komandanti i KFOR-it ka falënderuar myftiun Tërnavë për pritjen dhe nëpërmes tij ka vlerësuar lart punën dhe angazhimin që ka BIK-u për mirëqenien e të gjithë qytetarëve, duke vlerësuar kështu harmoninë ndërfaqetare, tolerancën dhe bashkëjetesën ndërmjet të gjithë qytetarëve pa dallim. Ai ka shfaqur gatishmërinë e tij dhe të KFOR-it për krijimin e sigurisë për të gjithë qytetarët dhe se bashkëpunimi ndërmjet BIK-ut dhe KFOR-it do të vazhdojë edhe më tutje.

Tetë raste të reja me Covid në Kosovë

Prishtinë, 8 nëntor - Në Kosovë u konfirmuan të hënën tetë raste të reja me Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se rastet e reja pozitive rezultuan pas testimit të 999 mostrave. Në 24-orëshin paraprak nuk u konfirmua asnjë viktimë nga Covidi, ndërsa u shëruan 6 pacientë. Aktualisht raste aktive me koronavirus janë 462. Me këto shifra Kosova ka shkallën më të

ulët të infeksionit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Për krahasim, shkalla e pozitivitetit në Mal të Zi sillet rreth 20 për qind, ndërsa në Kosovë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, është nën 1 për qind. Profesionistët shëndetësorë, megjithatë, kanë paralajmëruar se situata në rajon mund të importohet shpejt edhe në Kosovë dhe kanë bërë thirrje për

respektimin e masave kufizuese dhe për vaksinim. Deri të hënën mbi 741 000 qytetarë të Kosovës janë vaksinuar plotësisht kundër Covid-19. Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se 17 pacientë me Covid-19 dhe 33 me post-Covid janë duke u trajtuar në Klinikat e QKUK-së dhe në spitalet e përgjithshme. Sipas këtij



njoftimi, 15 pacientë janë me oksigjeno-terapi, ndërsa një

pacient është me maskë oksigjeni në mjekim intensiv.

Von Cramon: S'duam që Republika Sërpska të jetë monedhë për koncesionin e Serbisë ndaj Kosovës

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Raportuesja për Kosovën e Parlamentit Evropian, Viola von Cramon, ka thënë se nuk do ta krahasonte Kosovën me Republikën Sërpska si një entitet në Bosnje dhe Hercegovinë. "Unë nuk do ta krahasoja Kosovën dhe Republikën Sërpska si një entitet në Bosnje dhe Hercegovinë dhe as nuk do t'i lidhja në asnjë mënyrë. Këto janë çështje të veçanta dhe ne kemi të bëjmë me Bosnje e Hercegovinën ndaras nga dialogu Kosovë - Serbi. Nuk dua të spekuloj se entiteti boshnjak i Republikës Sërpska duhet të jetë monedha për koncesionin e Serbisë ndaj Kosovës. Thjesht, nuk e duam këtë që kur u ndal ndarja", ka thënë Viola von Cramon për "Aljazira Balkan".

Ajo ka shtuar se është e nevojshme që këto vende t'i drejtohen demokratizimit të tyre, zgjidhjes paqësore të çështjeve të brendshme dhe zbatimit të plotë të reformave që lidhen me Bashkimin Evropian dhe jo krijimit të vazhdueshëm të tensioneve dhe nacionalizmit.

Për mënyrën se si ajo i vlerëson marrëdhëniet aktuale në Ballkanin Perëndimor dhe me çfarë sfidash përballen, Viola von Cramon ka thënë se kriza aktuale i kujton Bashkimin Evropian se sa i rëndësishëm është rajoni i Ballkanit Perëndimor për



sigurinë dhe stabilitetin e përgjithshëm evropian. "Ka shumë çështje në rajon, por dy janë kryesore: dialogu strukturor ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe Bosnjë-Hercegovinës. Të dyja çështjet kanë tërhequr shumë

vëmendje, duke përfshirë krizën e fundit në veri të Kosovës (targat, lufta kundër korrupsionit) dhe kriza e vazhdueshme institucionale në Bosnje-Hercegovinë. Fatkeqësisht, rajoni nuk është një vend më i mirë, as

më afër Bashkimit Evropian, pavarësisht prej përpjekjeve tona për ta sjellë atë në klubin evropian sa më shpejt të jetë e mundur", ka deklaruar von Cramon.

I pyetur nëse largimi i Angela Merkelit nga politika do të

ndikonte në pikëpamjen e Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Cramon ka pohuar se ata shpresonin se qeveria e re gjermane do të kishte një qasje më të fortë dhe më strikte në rajon.

Haradinaj: Kosova po hyn në krizë të thellë sociale

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova po hynë në krizë të thellë sociale e që qytetarët kanë filluar të përballen me mbijetesë. Ai ka thënë se rritja enorme e çmimeve ka goditur çdo shtresë të popullsisë.

Haradinaj nëpërmjet një shkrimi të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka kritikuar qeverinë

për këtë gjë. "Kosova po hynë në krizë të thellë sociale. Qytetarët kanë filluar të përballen me mbijetesë. Rritja enorme e çmimeve ka goditur çdo shtresë të popullsisë. Qeveria e Kosovës i ka lënë në pozitë të vështirë kategoritë të cilat kanë bartur barrën kryesore të përballjes me pandeminë si pasojë e së cilës edhe ekonomia edhe bizneset kanë përjetuar goditje të rëndë. Për krejt këto arsye, sot jam me punëtorët shëndetësorë që protestojnë për të drejtat e tyre", ka thënë Haradinaj.

Ai ka theksuar se qeveria duhet të kthjellohet urgjentisht dhe të konsiderojë t'i gjitha masat e nevojshme që e lehtësojnë përballimin e kësaj situatë të rëndë. "Kërkesa jonë urgjente është që Ligji i Pagave të dërgohet për miratim në Kuvendin e Kosovës, si dhe përpilimi i buxhetit të ri të jetë në përputhje të plotë me nevojat imediate që reflektojnë përballjen me situatën e rëndë ekonomike e sociale", ka deklaruar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Meta takon eurodeputeten Santos: Të liberalizohen sa më parë vizat edhe për Kosovëna

TRIANË, 8 NËNTOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, të hënë ka pritur në takim raportuesen për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Isabel Santos. "Kënaqësi të takohesha me raportuesen për Shqipërinë, eurodeputeten Isabel Santos. Vlerësova angazhimin e saj dhe të Parlamentit Evropian në mbështetje të nisjes së negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Ramë dakord se

krimi i organizuar dhe emigracioni përbëjnë shqetësim serioz, që duhet trajtuar me përparësi", ka thënë Meta.

Presidenti Meta ka thënë se dita e sotme shënon 11-vjetorin e vendimit të Këshillit Evropian për liberalizimin e vizave me Shqipërinë. Ai ka theksuar se është e domosdoshme që ky proces të përmbillet me rajonin tonë, duke liberalizuar sa më

parë vizat edhe me Kosovën. "Të vetmit vend që nuk i është mundur ende kjo e drejtë edhe pas plotësimit të të gjitha kushteve. Theksova, gjithashtu, rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, duke u ndalur edhe në situatën shqetësuese të krijuar në Bosnje-Hercegovinë, së cilës Bashkimi Evropian duhet t'i kushtojë vëmendjen e duhur pa humbur kohë", ka deklaruar Meta pas takimit.



Sa është vlera e investimeve të huaja direkte në Kosovë?

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Investimet e Huaja Direkte (IHD) kanë një rëndësi shumë të madhe në zhvillimin e tërësishëm ekonomik të Kosovës. Janë disa faktorë që ndikojnë në prurjen e investitorëve të huaj. Në emisionin “7 Ditë me Panxhën” janë paraqitur disa statistika për vlerën e

investimeve të huaja në Kosovë. Vlera e IHD-ve vetëm gjatë muajit korrik kap shifrën e 46.2 milionë eurove investime, ndërsa viti 2021 shënoi një rritje të këtyre investimeve krahasuar me vitin paraprak. Por struktura e këtyre investimeve nuk ndikon aq shumë në zhvillimin ekonomik në plan afatgjatë,

pasi shumica e këtyre investimeve shkojnë në patundshmëri. Ndërsa vendet të cilat po investojnë më së shumti në Kosovë janë Gjermania, Zvicra dhe Shqipëria. Sa iu përket Investimeve të Huaja Direkte në vendet e rajonit, Kosova renditet e fundit.



Periudha	Gjithësej	Austria	Gjermania	Sllovenia
2019	254.6	11.9	70.2	6.8
2020	345.7	27.6	67.5	8.5
TM1	103.8	12.4	21.9	5.2
TM2	119.9	13.3	33.6	6.1

Kurti vizitoi ndërmarrjen vendore që bën përpunimin e frutave të malit



PRISHTINË, 8 NËNTOR - Në kuadër të “Ditëve të biznesit kosovar” dhe dialogut me biznesin privat, të organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kryeministri Albin Kurti së bashku me ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, vizituan ndërmarrjen vendore

që bën përpunimin e frutave të malit. “M’u duk shumë interesant rëfimi. Albani është i diplomuar për shkencë politike, ndërkaq Medina për mjekësi, e mesatarja është bujqësi edhe agropërpunim”, ka thënë Kurti në vizitën të ndërmarrja “Joni Sh”, me pronarë çiftin Alban edhe Medina Shabani.

Duke folur për ndihmën për prodhuesit nga qeveria, kryeministri veçoi vendimin që, përveç asaj që tashmë dihet, subvencionimin e gjysmës së kamatës, njëkohësisht do të subvencionohet edhe 20 për qind e kryeqjësë në kredi, pra principalin e kredisë. Ndërsa,

sipas tij, secili prodhues do të mund të marrë edhe 130 000 euro shtesë për t’i zgjeruar tregjet dhe për ta rritur cilësinë. “Në anën tjetër, buxhetin për vitin 2022 e kemi miratuar në mbledhjen e qeverisë, do ta sjellim në Kuvend për diskutim dhe aprovim së shpejti, me ç’rast buxheti për bujqësi do të

jetë mbi 70 milionë euro, pa përfshirë grantet dhe ndihmat që do t’i marrim prej jashtë, prej donatorëve të ndryshëm”, ka deklaruar kryeministri Kurti. Ai ka treguar se e kanë gjetur Ministrinë e Bujqësisë me 40 milionë euro obligime financiare dhe po e nxjerrin pa borxhe në vitin 2022.

ATK-ja për dhjetë muaj realizoi mbi 500 milionë euro të hyra

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 NËNTOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se ka mbledhur 512.5 milionë euro tatime për periudhën janar - tetor të vitit 2021. “Janë 512.5 milionë euro tatime të

mbledhura për periudhën janar - tetor 2021, të hyra këto të cilat tejkalojnë projeksionet e planifikuara për këtë periudhë kalendarike, duke shënuar rritje për 122.1 milionë euro apo 31.3 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar”, ka njoftuar ATK-ja, duke theksuar

se nëse i referohemi planit, ka rritje të inkasimit për 40.2 milionë euro apo 8.5 për qind. “Sipas këtij trendi, ATK-ja pret që deri në fund të këtij viti ta tejkalojë totalin e projeksionin për 2021. Indikatorët të cilët çdoherë janë duke dhënë rezultate për realizimin e objektivave janë shërbimet e

mira ndaj tatimpaguesve, të cilat afro 100 për qind janë digjitalizuar, po ashtu trajtimi i barbarët dhe profesional janë vlerë e shtuar e këtij reflektimi të performancës”, është shprehur në njoftimin e ATK-së. Administrata Tatimore ka falënderuar tatimpaguesit të

cilët kanë kryer obligimet e tyre tatimore si dhe ka inkurajuar gjithë pjesën tjetër të tatimpaguesve, të cilët, sipas analizave të bëra, nuk kanë deklaruar saktë pjesën që u takon, t’u përgjigjen thirrjeve të ATK-së, me qëllimin e vetëm që mos të bëhen objekt i masave ndëshkimore.

Numri i 12 i revistës “Akademia” ka dalë nga shtypi

Ka dalë nga shtypi, nën përkujdesjen e shtëpisë botuese “Armagedoni”, numri i dymbëdhjetë i revistës për letërsi, kulturë, gjuhë, media, “Akademia”. Në këtë numër të revistës prej shtatëqind faqesh janë botuar intervista, ese, ligjërata nga nobelistët e letërsisë, këndvështrime për libra, për filma artistikë dhe dokumentarë, fragmente romanesh, novelash, kujtimesh, tregime, poezi, dramë, studime për gjuhën dhe për letërsinë.

Revista është redaktuar nga: Agron Shala, Daut Dauti, Salajdin Salihu, Fadil Bajraj, Shpresë Mulliqi, Ali Pajaziti, Adem Gashi, Leonora Buçinca, Kristë K. Shtufi, Arif Molliqi.

Për këtë numër të revistës kanë përkthyer tekste nga gjuhë të ndryshme: Daut Dauti, Avni Spahiu, Fadil Bajraj, Kristë Shtufi, Verjon Fasho, Abdullah Karjagdiu, Klodi Briçi, Majlinda Çullhaj, Dea J. Klosi, Granit Zela, Fatijona Bajraj, Fortesë Frangu-Paçarada, Elvi Sidheri, Qerim Raqi, Lirak Karjagdiu, Emanuel Bajra, Iliaz Bobaj.

Revistën mund ta gjeni në librarinë “Artini” në Prishtinë.

Më poshtë përmbajtja e revistës.

PËRMBAJTJA

INTERVISTË

LULZIM TAFI

Shpirti i lirë është spontan ashtu siç është spontane edhe poezia, f. 7

LIGJËRATA

EARL RUSSELL

Cilat dëshira janë politikisht të rëndësishme?, f. 61

ELIAS CANETTI

Disa shënime mbi traditën moderne greke, f. 79

ESE

THEODOR HERZL

Shteti i hebrenjve, f. 95

ORHAN PAMUK

Berberët, f. 113
Zijafetet familjare dhe politika gjatë festave, f. 119

JAMES BALDWIN

Procesi krijues, f. 125

ANI KOKOBOBO

Ismail Kadare dhe e përbotshmja e letërsisë shqipe, f. 131

NELSON ALGREN

S'ka më shtëpi kurvash, f. 139

B. BENET DHE M. BERGER

Sociologjia dhe intelektualët, f. 145

DORIAN KOÇI

Letërsia e kujtesës kombëtare, f. 155

KËNDVËSHTRIME

SHEFKIJE ISLAMAJ

Shumësia kuptimore dhe estetika e metaforave në romanet e Rexhep Qosjes, f. 167

LIRAK KARJAGDIU

Utopia e Aldos Haksllit, f. 209

PETRIT PALUSHI

Rrëfimi për një zonë të mjegullt, f. 219

ALBIN MEHMETI

Egoja personale përballë shenjtërisë kolektive, f. 225

ARDIT MEHMETAJ

Maksima makiaveliste e zbatuar në romanin e Dostoevskyt dhe të Süskindit, f. 233

NOVELË

MACHADO DE ASSIS

Kisha e djallit, f. 239



Nr. 12

AKADEMIA
revistë për letërsi, kulturë, gjuhë, media

Orhan Pamuk
Earl Russell
Elias Canetti
Theodor Herzl
James Baldwin
Nelson Algren
B. Benet
M. Berger
Machado de Assis
Mari Henri Bel (Stendal)
Gustav Flobert
Victor Hugo
Ben Jonson
Samuel Daniel
F. Scott Fitzgerald
Rabindranat Tagora
Frank R. Stockton
Mevlana Celaleddin Rumi
Louisa Baldwin
Edith Södergran
Sabahattin Ali
Guy de Maupassant
Vladimir Aipa
Andrea Grill
Faruk Šehić

Flet:
Lulzim Tafa

Shenjë:

Gjergj Fishta
Migjeni
Faik Konica
Martin Camaj
Arshi Pipa
Krist Maloki
Zef Serembe

AKADEMIA
revistë për letërsi, kulturë, gjuhë, media



Shefkije Islamaj
Daut Dauti
Haqif Mulliqi
Qemal Murati
Ani Kokobobo
Lirak Karjagdiu
Dorian Koçi
Petrin Palushi
Arif Molliqi
Emin Z. Emini
Albin Mehmeti
Ardit Mehmetaj
Ramë Oraca
Ferdane Sahiti

Përkthyer për këtë numër: Daut Dauti, Arif Spahiu, Fadil Bajraj, Kristë Shtufi, Verjon Fasho, Abdullah Karjagdiu, Majlinda Çullhaj, Klodi Briçi, Dea J. Klosi, Granit Zela, Fatijona Bajraj, Fortesë Frangu-Paçarada, Elvi Sidheri, Qerim Raqi, Lirak Karjagdiu, Emanuel Bajra, Iliaz Bobaj

KUJTIME

MARI HENRI BEL (STENDAL)

Kujtime egotiste, f. 253

FRAGMENT ROMANI

GUSTAV FLOBER

Buvar dhe Pekyshtë, f. 263

VIKTOR HYGO

Një fjalë e shkruar mbi një fletë të bardhë, f. 305
Bû De La Ry, f. 308

TREGIME

ANDREA GRILL

Gjyshja gaforre, f. 315

FRENK STOKTON

Zonja apo tigri?, f. 323

MEVLANA CELALEDDIN RUMI

Deveja e Mexhnunit, f. 331
Deveja dhe miu, f. 332
Kapiten miza, f. 333
Vizita e të shurdhrit ndaj fqinjtit të sëmurë, f. 334
Macja apo mish, f. 336
Gomar i ngarkuar me kripë, f. 337
Përleshja për rrush, f. 338

GUY DE MAUPASSANT

Stolitë, f. 339

LOUISA BALDWIN

Gjithë ujërat e botës nuk mund të mposhtin dashurinë, f. 347

F. SCOTT FITZGERALD

Rasti i rrallë i Benjamin Kopsës, f. 357

ALBIN MEHMETI

Humanisti, f. 391
Festivali i ujëvarës, f. 396

POEZI

EDITH SÖDERGRAN

Dita ftohet..., f. 403
E zezë apo e bardhë, f. 404
Natë yjesh, f. 405
Fjalë, f. 406
Nëpër pyjet e thella, f. 406
Pranverë nordike, f. 406
Vendet e largëta, f. 407
Mos lejo ta humbësh krenarinë, f. 407

SABAHATTIN ALI

Këngë burgu I, f. 407
Këngë burgu II, f. 408
Këngë burgu III, f. 408
Këngë burgu IV, f. 409
Këngë burgu V, f. 410

RABINDRANAT TAGORA

Një shportë me fruta, f. 411
Gjerdani i margaritart, f. 412
Çdo agim i zotit, f. 412

BEN JONSON

Poezi kushtuar Selisë, f. 415
Hija, f. 415

SAMUEL DANIEL

Dashuria është sëmundje, f. 417

VLADIMIR AIPA

Ndiznin dhomën xixëllonjat..., f. 419
Fragment, f. 420
Epifani, f. 420
Homo sapiens..., f. 421
Heshtja vret të dashuruarit, f. 421
Një ditë më vonë i them gruas..., f. 422
Burrat pendohen shpejt, f. 422
As etruskët s'qenë aty..., f. 422
S'ishte lojë, ishte e puthur, f. 423
Internetit vjen si flutur, f. 424
Altruist, f. 425
Të betohem, kërkon dy, f. 426
Ju pres..., f. 427

FARUK ŠEHI

Duke kaluar pranë markalës për një çast u ndala, f. 437
Pa barrë në shpinë përveç asaj të vdekjes, f. 438
Të nesërmen e lexova në kronikën e zezë, f. 438
Lojë lufte, f. 439
Rregullat dhe detyrat, f. 440

EMIN Z. EMINI

Psalm i mëkatshëm, f. 443
Antikomedi e kaltër, f. 445
Poezi tjetër, f. 447
Sonet i pakryer, f. 450
Sonet i përkormë i ditëve me kurorë, f. 450
Këputur degësh, f. 451
E sotmja, f. 451
E djeshmja, f. 452
E nesërmja, f. 453

ARIF MOLLIQI

Motiv tjetër, f. 455
Ditëlindja e një moshe, f. 456
Nëna ime, heroina ime, f. 456
Kur e varrosëm babën, f. 457
Ceremonia e varrimit, f. 458
Njeriu që bart sëmundjen, f. 459
Duke pritur radhën në spital, f. 459
Kur e paguaj mërzinë, f. 460
Ata e hanë edhe lirinë, f. 461
Diçka s'më hiqet nga mendja, f. 461

RAMË ORACA

Dilemë, f. 463

Kërbaçi

f. 464
Sytë e shpresës, f. 464
Ëndrra e babës, f. 465
Pleqnari i fundit, f. 465

FERDANE F. SAHITI

Asgjë, f. 467
Zbrazët, f. 468
Era telashe, f. 468
Tamam njeri, f. 469

DRAMË

HAQIF MULLIQI

Katër epoletat, f. 473

GJUHË

QEMAL MURATI

Kosova në toponime (II), f. 549

SHENJË

FAIK KONICA

Ca këshilla mbi artin e shkrimit, f. 583
Malli i atdheut, f. 586

MIGJENI

Kryesorja në art, artistikja, f. 587

KRIST MALOKI

Naim Frashëri, f. 591

ZEF SEREMBE

Kënga e mallit të parë, f. 625
Vrull, f. 627
Vashes së largët, f. 628
Këngëtari dhe bilbili, f. 629
Fytyra e saj, f. 630
Një ditë është jeta, f. 630
Te bregu i detit, f. 631
Ali Tepelenasit, f. 631

GJERGJ FISHTA

Nji lule vjeshtet, f. 633
Metamorphosis, f. 638

MARTIN CAMAJ

Vendin tem, f. 647
Drekë malsore, f. 647
Mosha e qenit apo ditëlindja, f. 648
Heroi nën barrën e vet, f. 649

ARSHI PIPA

Poezia dhe poetika e Martin Camajt, f. 651

KINEMATOGRAFI

DAUT DAUTI

Analizë dokumentarësh dhe filmash, f. 671

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

'Dardanët' fillojnë grumbullimin, konfirmohen tri mungesa



"Epoka e re"
PRISHTINË, 8 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka filluar, për dy ndeshjet e fundit të vitit 2021, miqësoren ndaj Jordanisë, që zhvillohet të mërkurën në Prishtinë dhe përballjen e fundit kualifikuese për Kampionatin Botëror "Katar 2022" që zhvillohet të dielën ndaj Greqisë në Athinë. Tre futbollistë që ishin pjesë e listës së përzgjedhësit Gliha nuk do t'i bashkohen ekipit në këtë grumbullim. "Elbasan Rashani ka pësuar lëndim në ndeshjen e fundit me klubin e tij, kurse Lirim Kastrati e Bersant Celina me kërkesën e tyre, për shkak të situatave respektive në klubet e

tyre, janë liruar nga obligimet me ekipin kombëtar për këtë grumbullim", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. Po ashtu, mbetet për t'u vlerësuar situata e Zymer Bytyqit, që ka pësuar lëndim në ndeshjen e djeshme me klubin e tij. Bytyqi është duke i kryer ekzaminimet mjekësore me klubin e tij dhe më pas do të merret vendimi definitiv për të. Të hënën pasdite janë zhvilluar stërvitjet e të dyja skuadrave në stadiumin "Fadil Vokrri".
Sot (e martë) Kosova dhe Jordania do t'i zhvillojnë stërvitjet e radhës dhe do të mbajnë konferencë për media. Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se të hënën me fillim nga ora 15:00 kanë ndalë në treg biletat në pikat e

"Armotion" për ndeshjen miqësore Kosovë - Jordani. Miqësorja në fjalë do të zhvillohet të mërkurën më 10 nëntor në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën 18:00. Edhe në këtë ndeshje, në bazë të masave kundër Covidit të Qeverisë së Kosovës, do të lejohet shfrytëzimi 30 për qind i kapacitetit të stadiumit. Një person mund të blejë deri në 2 bileta me letërnjoftim. Çmimet e biletave janë sikurse në ndeshjet e kaluara: Perëndim 20 euro, Lindje 10 euro, Veri dhe Jug 5 euro. "Biletat mund t'i blini në dy pikat e Armotion në Prishtinë - në Pejton (rruga Perandori Justinian) dhe në Grand Hotel (Sheshi Zahir Pajaziti)", thuhet në njoftimin e FFK-së.

SHKURT

Strakosha në Premierë Ligë, Newcastle e kërkon me ngulm

Thomas Strakosha që nga janari mund të kalojë në Premierë Ligë. Tabloidi britanik "The Sun" raporton se gardiani 26-vjeçar shqiptar nuk ka ndër mend të rinovojë me Lazion dhe po përgatitet për t'u larguar me parametra zero në fund të sezonit. Megjithatë largimi nga kryeqyteti i Romës mund të vijë që në janar, pasi klubi i Newcastle Unitedit është vënë në lëvizje dhe ka treguar gatishmërinë për të paguar edhe një shifër simbolike në arkat e Lazios, për ta marrë menjëherë portierin. Klubi anglez ka kaluar në pronësinë e fondit arab PIF dhe pritet të investojë fuqishëm për ta shmangur rënien nga Premiera Liga e më pas nga sezoni i ardhshëm për ta synuar ngjitjen në vendet e kreut të renditjes. Strakosha shihet si zgjedhja e duhur në portë, duke marrë në konsideratë faktin që portieri gardiani shqiptar ka shumë përvojë në Serinë A, teksa para ardhjes së Reinës ishte ndër më të spikaturit.

Aston Villa në bisedime me Gerrardin

Legjenda e Liverpoolit, Steven Gerrard, mund të rikthehet në Premierligë, por kësaj radhe si trajner. Gerrardi aktualisht është trajner i Rangers, por që mund të largohet në ditët e ardhshme. Siç raporton "MailSport", Aston Villa tashmë ka filluar bisedimet me Gerrardin për ta marrë drejtimin e skuadrës, e cila pak ditë më parë e shkarkoi trajnerin Dean Smith pas rezultateve jo të mira. Përveç Gerrardit, Aston Villa në listë ka edhe emra si: Ralph Hasenhuttl, Thomas Frank, Kasper Hjulmand, Lucien Favre dhe Paulo Fonseca. Megjithatë, Gerrardi kryeson listën e klubit dhe dëshiron të marrë një përgjigje të shpejtë nga ai.

Kosova barazon me Belgjikën

Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll e ka fituar pikën e parë në kualifikimet për Botërorin 2023. Të dielën mbrëma në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë Kosova luajti dhe mbeti baras 28:28 me Belgjikën. Barazimi erdhi pas humbjes së pësuar nga Turqia në Eskishehir. Në fund të ndeshjes lojtarët tanë kishin sulme për të shënuar fitore, por nuk i realizuan. Pas pjesës së parë Kosova kishte epërsi prej dy golash, 14:12, por në pjesën e dytë gjërat nuk funksionuan ashtu si shpresohesh. Ndeshjen më mirë e hapi Belgjika që ishte në epërsi deri në minutën e 15. Më pas Kosova nisi shpëputjen dhe krijoi epërsi prej tri golash, 10:7. Pas 30 minutave rezultati ishte 14:12. Në pjesën e dytë u luajt për secilën gol, ndërsa në epërsi të lehtë ishim herë ne e herë belgët. Pasi Jon Muqolli barazoi rezultatin në 25:25, Deniz Terziqi shënoi dy herë rresht për 26:25 e 27:26, por belgët barazuan në 27:27 dhe pas shënimit të Kastriot Jupës edhe në 28:28. Aksionet e fundit nuk i realizoi asnjëra palë. Më efikas ishte Drenit Tahirukaj me gjashtë gola. Nga 4 gola i shënuan Deniz Terziqi e Egzon Gjuka. Në ndeshjen tjetër të grupit të parë të fazës së parë kualifikuese, Greqia fitoi 24:20 ndaj Turqisë. Greqia udhëheq me katër pikë, Turqia i ka dy pikë, ndërsa Belgjika e Kosova e kanë nga një. Ndeshjen e ardhshme Kosova e luan më 5 janar, kur e pret Greqinë në Prishtinë. Dy vendet e para në grup sigurojnë avancimin tutje.

Reja: Xhaka e braktisi Shqipërinë

TIRANË, 8 NËNTOR - Trajneri Edy Reja ka folur edhe një herë për situatën e Taulant Xhakës në kombëtaren e Shqipërisë. Sipas trajnerit italian, Xhaka është ai që e ka refuzuar në vazhdimësi ftesën

e kombëtares. "Xhaka thotë gënjeshtër, por ai po tallet me të gjithë ne. Një herë nuk e kam grumbulluar, por më pas ka refuzuar gjithmonë. Ai thoshte që nuk jam mirë, por ndërkohë luante me klubin.

Balliu do të vijë, por më tha pse nuk po vjen këtë herë për këtë problem shëndetësor. Është një situatë krejt tjetër. Xhaka nuk ka qenë i ndershëm me Shqipërinë dhe me mua, sepse i kemi çuar

ftesë gjithmonë, por nuk vinte sepse pretendonte se ishte i dëmtuar. Unë nuk e braktisi asnjë, ndërsa ai e braktisi Shqipërinë. Ta sqarojmë këtë gjë një herë e mirë", ka thënë Reja.



Verstappen: Parakalimi i dyfishtë në start ishte i planifikuar

Mexico, 8 nëntor - Max Verstappen ishte protagonist i garës së Meksikës në Formula 1, me atë parakalim fantastik të dyfishtë që bëri në start. Piloti holandez i Red Bullit nisej nga vendi i tretë, por që pas kthesës së parë ai e pa veten në krye të garës,

duke parakaluar dy pilotët e Mercedesit, Valtteri Bottas e Lewis Hamilton. Ky parakalim dhe marrja e komandës së garës i dha mundësi Verstappenit të bëjë një garë të qetë dhe të fitojë, duke e çuar në 19 pikë avantazhin ndaj britanikut.

“Pista e gjerë më dha mundësi të sulmoj që në start. Arrita ta marr komandën e garës dhe më pas u përqendrova te gara ime”, u shpreh Max Verstappen. “Kur je në garë gjithnjë përpiqesh të frenosh sa më vonë për të fituar

teren. Këtë gjë bëra edhe unë, pasi këtë gjë e kishim studiuar dhe planifikuar më parë. Unë e dija saktësisht se ku dhe kur duhej të frenoja në kthesën e parë. Unë frenoja më vonë dhe pata të drejtë, pasi gara u vendos aty”, ka shtuar Verstappen.



Xavi paraqitet trajner i Barçës: Jam i përgatitur për këtë sfidë

BARCELONË, 8 NËNTOR - Legjenda e Barcelonës, Xavi Hernandez, është paraqitur trajner i skuadrës nga “Camp Nou”. Xavi u emërua trajner i Barcelonës pas shkarkimit të Ronald Koemanit, duke nënshkruar marrëveshje deri në vitin 2024. Ish-mesfushori i njohur është i bindur se mund ta kthejë klubin në binarë. Barça e mori dritën e gjelbër për emërimin e tij të premtën, pasi e pagoi klauzolën e lirim të kontratës së 41-vjeçarit me klubin e Katarit, Al-Sadd.

Xavi, i cili luajti 17 vjet për Barcelonën duke i fituar 25 trofe në 767 paraqitje, tha: “Jam i përgatitur. Më pëlqejnë sfidat. Ekipi ka talent dhe unë do të përpiqem ta përçoj përvojën time te lojtarët për të fituar tituj. Unë e njoh Barçën, e njoh



klubin, është një çast delikat në historinë e klubit, ekonomikisht dhe në fushën e lojës. Ne duhet t'i lëmë anash dallimet tona dhe të bashkohemi”, ka thënë Xavi. Xavi do ta marrë në dorën Barçën në vendin e nëntë në

tabelën e La Ligës, me 11 pikë larg liderit Real Sociedad dhe gjashtë pikë larg top katërshe. Ndeshja e tij e parë si trajner i Barcelonës do të jetë kundër Espanyolit më 20 nëntor në “Camp Nou”.

Golden State regjistron fitoren e tetë, dështojnë Utah dhe Milwaukee

WASHINGTON, 8 NËNTOR - Kampioni në fuqi i NBA-së, Milwaukee Bucks, nuk po kalon një moment të mirë, duke u mundur me rezultat 101-94 nga Washingtoni. Humbje që zbratë Bucksin në vendin e dhjetë në Lindje. Antetokounmpo realizoi 29 pikë e 18 rebounde për miqtë, por që s'mjaftuan, ndërsa për Washingtonin u dallua Beal me 30 pikë. Golden State është për momentin ekipi



më i mirë në NBA, duke korrur fitoren e tetë. Warrirosi fitoi me rezultat 120-107 ndaj Houstonit, sfidë ku Poole realizoi 25 pikë e Curry 20.

Zhgënjën ekipi i Utah Jazzit, që u mund 107-100 nga Orlando, humbja e dytë radhazi. Cole Anthony me 33 pikë ishte më i miri për Orlandon.

NBA

New York - Cleveland	109-126
Orlando - Utah Jazz	107-100
Sacramento - Indiana	91-94
Washington - Milwaukee	101-94
Oklahoma - San Antonio	99-94
Golden State - Houston	120-107
Clippers - Charlotte	120-106

SHKURT

Milani arrin rekordun unik në Serinë A

AC Milan ka barazuar 1-1 në derbin ndaj Interit në stadiumin “Giuseppe Meazza”, duke ndarë edhe kreun e renditjes me Napolin. Në ndalesën kundër Interit, skuadra e Stefano Piolit arriti rekordun e veçantë në Serinë A italiane. Sipas faqes së statistikave “OPTA Paolo”, Milani ka koleksionuar 32 pikë pas 12 javëve në Serinë A për herë të parë në epokën e tri pikëve për fitore. Një statistikë dhe rekord unik për kuqezinjtë teksa shohin veten ende të pamposhtur në kampionat.

Solskjaeri, afër shkarkimit

Trajneri Ole Gunnar Solskjaer mund të shkarkohet nga detyra e trajnerit në Manchester United. “MailSport” raporton se Unitedi ka marrë ankese për trajnerin nga lojtarët dhe duhet t'i ndajnë rrugët. Humbja 5-0 ndaj Liverpoolit ka lënë pasojë të mëdha edhe pse në xhiron e parafundit triumfoi ndaj Tottenhamit. Situata u rëndua edhe më shumë kur Unitedi pësoi humbje 2-0 ndaj rivalit lokal Cityt, me lojtarët që shprehën frustrimin. Lojtarët e Manchester Unitedit kanë kërkuar që Solskjaer të shkarkohet dhe vendin e tij mund ta zë Zinedine Zidane ose Erik ten Haag. Francezi është aktualisht i papunë qëkur u largua nga Real Madridi, ndërsa Ten Hag po tregon suksese të mëdha tek Ajaxi.

Reali nxjerr 6 lojtarë në shitje

Real Madridi është i hapur që të largojë gjashtë futbollistë në afatin kalimtar të janarit. “Los Blancos” e ka nisur mirë këtë sezon, duke u renditur në pozitën e dytë në tabelë, prapa liderit befasues Real Sociedad, mirëpo ka një ndeshje më pak të zhvilluar. Në të njëjtën kohë, klubi madrilen vazhdon të jetë i lidhur me nënshkrimin e futbollistëve si Kylian Mbappe dhe Erling Haaland, por presidenti Florentino Perez duhet t'i zbratë pagat në muajt në vijim. Sipas “AS”, Reali është gati t'i ndajë rrugët në janar me disa nga lojtarët më të paguar, si Isco dhe Gareth Bale. Dy lojtarët e lartpërmendur dhe Marcelo do të jenë agjentë të lirë në verë dhe do të largohen falas në rast që nuk shiten në janar. Gjithashtu edhe Jesus Vallejo dhe Luka Jovic që nuk kanë qenë titullarë këtë sezon e kanë derën hapur për t'u larguar. Eden Hazardi çuditërisht është në listën e shitjeve të Realit, por ende është e paqartë nëse është gati për të marrë një sfidë tjetër.

Inzaghi: Meritiam më shumë se një pikë ndaj Milanit

Trajneri Simone Inzaghi këmbëngul se Interi ka merituar më shumë se një pikë në derbin e Milanit. Hakan Calhanoglu e ka shënuar golin e parë, teksa më pas Stefan de Vrij shënoi autogol. “Patëm më shumë raste dhe humbëm një penallti kështu që, sipas meje, meritoni më shumë se një pikë. Ne ishim përballë një ekipi të madh që me meritë është në krye të tabelës. Ne jemi prapa tyre për sa i përket progresit, por ka kohë për t'u rikthyer në rrugën e duhur dhe paraqitjet si kjo do të na japin besim”, ka thënë Inzaghi për “DAZN”. “Në gjashtë ndeshjet e fundit ne barazuam me Juventusin dhe Milanin, kur ndoshta e meritiam të fitonim. Milani dhe Napoli po mbajnë një ritëm të jashtëzakonshëm, por ka një rrugë të gjatë për të bërë dhe ne jemi atje lart”, ka shtuar Inzaghi.

Jota e krahason Salahun me Ronaldon


Sulmuesi i Liverpoolit, Diogo Jota, ka thënë se Mohamed Salah është duke e arritur nivelin e superyllit të Manchester Unitedit, Cristiano Ronaldo, pas një fillimi të shkëlqyer të sezonit

2021/22. Salah i ka shënuar 15 gola në 14 paraqitje për Liverpoolin këtë sezon dhe për më tepër është edhe asistuesi më i mirë në ekip me gjashtë sosh. “Ai po shënon gola për argëtim. Gola madhështorë,

gola individualë dhe kjo po na ndihmon sepse e kemi dikë në fushë i cili mund të vendosë për ndeshjen. Ndërsa kundërshtarët e dinë se duhet të jenë të kujdesshëm dhe ne mund t'i shfrytëzojmë

hapësirat që ata i lënë për shkak se brengosen për të. Ajo ndjesia e parë kur luajta me Ronaldon në ekipin kombëtar dhe mendoj se mund ta fus atë (Salahun) në të njëjtin standard me të, megjithëse

Ronaldo e ka bërë këtë për një kohë shumë të gjatë. Ata janë të rrezikshëm dhe mund të shënojnë në çdo kohë. Për mua kjo është e dobishme sepse mund t'i shikoj dhe të mësoj nga ta”, ka thënë Jota.



Kryetari i Komunës 01-nr.464- 69176, Dt. 05.11.2021 - Suharekë

Ne bazë të nenit 4, nenit 10 të Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.03/L-139 dt. 26 mars 2009 të Republikës së Kosovës dhe Ndryshim plotësimi i Ligjit mbi shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr.03/L-205 dt. 10 dhjetor 2010, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative O/L-031, bazuar në Vendimin Nr. 01 nr.464-40195, dt.15.07.2021 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, brenda afatit ligjor, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë :

VENDIM PRELIMINAR

(Për ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

I. SHPRONËSOHET prona private e pronarve dhe zotuesve të interesit, për interes publik për ndërtimin e kanalit për ujra dhe rrugës publike e cila gjendet në Pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116046-01895-1, në sip. prej: 1259 m² në vendin e quajtur "Jazi-Osoja" e evidentuara sipas qertifikatës se pronë emër të Nehat (Rasim) Berisha , ZK. Suharekë.

II. Vërtetohet se ndërtimi e kanalit për ujra dhe rrugës publike në Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluajtshmerisë së lartëcekur është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes e këtij qëllimi.

III. Zotuesi i interesit të pronës se cekur në pikën 1. të këtij Vendimi do të kompenzohet konform dispozitave në fuqi të Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtshme.

IV. Vendimin Preliminar, brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit të tij, Organi shpronësues do të ia dergon, zotuesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se u takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar, bazuar në nenin 10 paragrafi 3 të këtij Ligji.

V. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, Organi shpronësues e shpall Vendimin në një gazetë zyrtare me tirazh me të madhë në Kosovë, ndërsa ky vendim hynë në fuqi ditën e shpalljes në këtë Gazetë

Arsyetim

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës konstaton se shpronësimi i paluajtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv të këtij Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtat

private, se pjesa e pronës së paluajtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji .

Organi shpronësues-Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluajtshmerisë Nr. 01 nr.464-40195, dt.15.07.2021 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkues-Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik dhe për ndërtimin e rrugës publike në Suharekë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkues është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejtë të dorëzojë në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:

Subjektit kërkues

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit

Kryetari i Komunës
Bali Muharremaj

Njoftim

Njoftojme të gjithë klientet se Kompania "BonFinance" SHPK –me seli në Prishtinë, Adresa: Bulevardi Nena Terez nr22", ka marrë vendim për shuarje të biznesi me NUI 810870198 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientet që kanë raporte kreditore-debitore në këte shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazete.

Obavestjenje

Obavjestavamo sve klijente da Tvrtka "BonFinance" SHPK –Kosove u Pristinu, Adresa: Lupisht-Prizren", doneo odluku da ugasi biznis po br.NUI 810870198 i ujedno imenovao Likfidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze I potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novine.

Announcement

All clients are to be informed that the Company "BonFinance" SHPK –in Prizren, Adresa: Lupisht-Prizren", has come to the decision to quit its business with registry NUI 810870198. The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► D.P.H. "ROZA", Iliri Konjusha B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811262881, nrb. 70949997, nr. fis. 600959300.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



Kompania Rajonale e Ujësjellësit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

KRU "GJAKOVA" SH.A.		
Mastë në datën:	09.11.21	
hyesia.org	Numri	Shifra
	728	

Në bazë të dispozitave të nenit 21, nenit 25, paragrafit 25.2, pika h) e Ligjit Nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 31/2008 (dt.15.06.2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/2012 (dt. 30.05.2012), dhe Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe Udhëzimit Administrativ nr 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komisioni i Auditimit i Ndërmarrjes Publike K.R.U "Gjakova" SH.A., në Gjakovë, mori vendim që të rishpall:

KONKURS

Titulli i vendit të punës - Auditor/e i/e Brendshëm/e

Numri i referencës: 728

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: Në Kohë të caktuar/ Puna Provuase gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit

Përshkrim i detyrave të punës:

- Vlerëson procesin e veprimeve kontrolluese në tërë ndërmarrjen bazuar në vlerësimin e përshtatshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm
- Respekton legjislacionin e përgjithshëm në fuqi, kodin e etikës dhe sjelljes, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga Udhëheqësi i Ndërmarrjes dhe Komiteti i Auditimit;
- Vlerëson nëse dizajni i procesit të kontrollit, siç është bërë dhe paraqitur nga menaxhmenti është adekuat
- Kryen auditime individuale për të siguruar përshtatshmërinë e objektivave dhe fushëveprimit të auditimit, përshtatshmërinë e testimit të kryer dhe saktësinë e konkluzioneve të arritura
- Përcakton nëpërmjet të testimit dhe procedurave të tjera, nëse procesi në fakt është duke funksionuar në mënyrë efektive dhe efikase ashtu siç është synuar
- Raporton rezultatet e punës së kryer të auditimit dhe ofron rekomandime aty ku ka nevojë për përmirësimin e procesit të kontrollit
- Raporton rregullisht tek Drejtori i Njësisë për Auditim të Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit dhe përbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e tyre

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Diplomë universitare në Ekonomi, Juridik, Administratë Publike, Financa Publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet 4 vjeçar, si dhe me Sistem të Bolonjes 3+2, diplomat e universiteteve jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara.
- Duhet të ketë certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave.
- Kandidati/ja duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë menaxheriale në fushën e administrimit të biznesit, financave, kontabilitetit apo nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të K.R.U "Gjakova" Sh.A. – e preferuar është përvoja në auditim të brendshëm në sektorin publik.
- Të posedoj aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe organizimi të punës.
- Njohja e punës me kompjuter: Word, Excel dhe PowerPoint.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj)
- Të ketë aftësi për të interpretuar dhe zbatuar Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe legjislacionin në fuqi që i përgjigjet veprimtarisë së ndërmarrjes.
- Njohja e gjuhës angleze do të jetë përparësi.
- Të ketë shkathtësi të prezantimit dhe raportimit.

Paga mujore: Sipas Rregullores në fuqi.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Procedura për aplikim: - Aplikacioni (formulari) për konkurrim merret në Kompani dhe në web-faqen e Kompanisë, dhe të njëjtës i bashkangjiten:

- Kopja e letërnjoftimit
- Certifikata e lindjes
- CV-ja
- Letër Motivuese / kërkesa për punësim
- Kopjet e dokumentacionit të kualifikimit (kopja e noterizuar), përvoja e punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

I gjithë dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në zarfë të mbyllur në adresën zyrtare: Objekti Administrativ KRU "Gjakova" Sh.A/ Rruga UÇK NR 7/ Kati II - Zyra e Protokollit. Konkursi mbetet i hapur tridhjetë (30) ditë kalendarike, afati i fundit për aplikim është data 08.12.2021 deri në ora 16:00h.

Vërejtje: Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurimit do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

